



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 58

Prishtinë, më 31. 10. 2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Fatmir Xhelili, Bislim Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Valdete Bajrami, Kujtim Paçaku dhe Slobodan Petroviq.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.10.2016;
3. Raportim i z. Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 100 për ndihmën shtetërore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit i datës 18.10.2016;

Procesverbali i datës 18.10.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i z. Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik;

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, raportimin e tij e nisi me përmbushjen e veprimeve nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së në rrafshin e zhvillimit ekonomik si dhe Fondet e IPA-II.

Ai tha se MZHE-ja si hartuese e politikave të fushave të caktuara është përgjegjëse në zbatimin e neneve konkrete në kuadër të MSA-së.

Duke e ditur se pjesa më e madhe e aktivitetit të MZHE-së lidhet me energjinë si një sektor dhe parakusht i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik, atëherë e filloi me pjesën e kapitullit 15.

Sa i përket masave legislative, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe zbatimit të marrëveshjes së komunitetit të Traktatit të energjisë, në të cilën jemi edhe nënshkrues dhe tani kemi marrë edhe presidencën, është miratuar edhe pakoja e 3-të e energjisë e që është një nga detyrimet tona kryesore ligjore që lidhet me agjendën e interkonuktivitetit në kuadër të procesit të Berlinit.

Në këtë drejtim pakoja e 3-të e ligjeve që janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, konsiderohet si njëra prej të arriturave më të mëdha të shteteve të regjionit dhe më gjerë. Jemi në fazën finale të përgatitjes për procedim të Ligjit për Efiqencën e energjisë dhe si pjesë përbërëse e tij do të jetë fondi për efiqencën e energjisë që është njëra nga shtyllat kryesore në të cilën do të mund të zbatohen edhe masat e kursimit.

Sa i përket Kapitullit të Energjisë/ masat zbatuese për kapitullin 15, është përgatitur drafti i Strategjisë së Energjisë 2016-2025, i cili ka qenë në diskutim publik.. Programi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2016-2018, do të hartohet pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ndërtimi dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, pranimi i ofertave dhe zgjedhja e ofertuesit fitues të preferuar për TC “Kosova e Re” ka përfunduar në dhjetor të vitit 2015. Mbyllja komerciale është në përfundim e sipër, ndërsa shprehja e interesit pritet të ndodhë në fund të këtij viti, kurse mbyllja financiare gjatë vitit 2017.

Stavileci foli edhe për dekomisionimin e TC “Kosova A”, trajnimin për anëtarët e grupit punues dhe Departamentit për dekomisionim në KEK, procedurat për lejet e nevojshme për dekomisionim të objekteve, inventarizimi i të gjitha materialeve të mbeturinave si dhe përcaktimi i lokacionit për mbeturinat jo të rrezikshme.

Te Kapitulli 3 i acquis: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve në kuadër të masave zbatuese, ai tha se kemi koncept dokumentin për amendamentim të ligjit ekzistues për shërbimet postare. Ky draft është finalizuar dhe pritet të procedohet më tutje.

Zgjerimi i mëtutjeshëm i hapësirës territoriale për ofrimin e shërbimeve universale postare i paraparë në dokumentin "Politikat Strategjike të Shërbimit Postar në Republikën e Kosovës 2013-2017, nënkupton shtrirjen e ofrimit të shërbimit universal edhe në territorin e veriut të Kosovës, për realizimin e të cilës varet nga zhvillimet tjera politike. Kjo varet nga ndryshimi i

Kodit Postar, të paraparë në dokumentin "Politikat Strategjike të Shërbimit Postar në Republikën e Kosovës 2013-2017 dhe Informatizimi i rrjetit dhe i shërbimeve postare.

Stavileci foli edhe për Kapitullin 10 të acquis, draftin e Rregullores për mbledhjen e të dhënave për infrastrukturën brezgjërë, të projektit për krijimin e Atlasit Elektronik të Infrastrukturës Telekomunikuese Brezgjërë, që do të procedohet më tutje.

Nga Komisioni Evropian është aprovuar kërkesa për asistencën teknike të TAIEK-it dhe sipas agjendës së aprovuar, pritet që gjatë periudhës raportuese të realizohet aktiviteti.

Lidhur me Fondet e IPA II- IPA 2014, Stavileci tha se pas hartimit të projekteve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komisioni Evropian ka mbështetur Kosovën me këto dy projekte; Asistencë teknike për procesin e dekomisionimit të TC "Kosova A" dhe studimi i fizibilitetit të "Kosovës B".

Në kuadër të IPA 2015, aktivitetet janë si në vijim:

1. Projekti për rehabilitimin e ngrohtores në Gjakovë dhe në Prishtinë dhe projekti i ndërtimit të depozitës për mbeturinat e rrezikshme në shumë prej 12 milionë euro...

Kryetari pyeti ministrin se cilat janë objektivat e Presidencës së Kosovës në kuadër të objektiveve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, pasi u tha se Kosova e ka radhën e presidencës.

Donika Kadaj -Bujupi, pyeti lidhur me 300 punëtorët e KEDS-it, të cilët janë larguar nga puna 3 vite pas privatizimit, Ajo tha se në kohën kur është bërë privatizimi, Qeveria e asaj kohe e udhëhequr nga PDK-ja ishte zotuar se do të bëjë 300 milionë euro investime dhe nuk do të ketë largime të punëtorëve nga puna, por përkundrazi do të rritet numri.

Investimet nuk kanë ndodhë por kohë pas kohe bëhet vetëm mirëmbajtja e rrjetit.

Ky largim i 300 punëtorëve përbën shkelje të Ligjit të punës sepse është largim kolektiv. Ata çdo ditë po protestojnë dhe nuk po marrin përgjigje nga Qeveria përveç të një vendimi, i cili është lëshuar nga Inspektorati i Punës përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili konfirmon se është shkelje e ligjit dhe kërkon nga KEDS-i që të tërhiqet vendimi, dhe pyeti ministrin për hapat që do të ndërmerren, në mënyrë që këta punëtorë të kthehen në punë.

Kadaj-Bujupi foli edhe për faturimin dhe inkasimin e energjisë elektrike, ku siç u tha gjatë raportimit të ministrit se nivelet janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme pas privatizimit të KEDS-it, pyeti se a është përfshi edhe veriu i Mitrovicës, cila është gjendja aktuale e shpërndarjes, faturimit dhe inkasimit, sepse çka ne po dëgjojmë, konsumatori i Kosovës po e paguan çmimin më të shtrenjtë ngase në faturat tona po përfshihet energjia e shpenzuar në veri të vendit dhe po konsiderohet si humbje komerciale.

Kadaj-Bujupi pyeti edhe për kontratë e cila paralajmëron dhënien e një licence për gazifikimin e qymyrit në Basenin e Dukagjinit, e cila përveç që është një metodë e rrezikshme shkakton edhe ndotjen e tokës dhe të ujërave.

Fatmir Xhelili pyeti ministrin, se në kuadër të prodhimit të energjisë elektrike, a keni të dhëna në mes të energjisë së prodhuar dhe energjisë së regjistruar nëpër njehsor, sepse desha të dija se sa faktikisht është humbja teknike apo komerciale.

Çka keni planifikua të dekomisionimi i termocentralit "Kosova A" në cila është diferenca me fillimin e termocentralit të ri "Kosova e Re"..

Vjosa Osmani tha se do të ndalem të një çështje tjetër që është pjesë e MSA-së dhe kapitullit 3, që e përmendët edhe ju, që ka të bëjë me shërbimet postare.

Ndoshta mund të na sqaroni pak ma shumë. Nga praktika e kemi vërejt që përkundër faktit që na kanë njohur rreth 112 shtete, mënyra se si e kanë rregulluar çështjen e dërgimeve postare në

Kosovë është krejt individuale, në shtete të caktuara në postën e tyre në momentin kur shkruhen adresa për Kosovën, automatikisht sistemi i tyre vendos edhe Serbinë .

Sa jeni në kontakt me shtete veç e veç, në baza bilaterale, për të kërkuar në emër të Republikës së Kosovës që sistemi i tyre të azhurnohet, në mënyrë që Kosova të mos të jetë në sistemin e tyre në suaza të Serbisë, ngase pastaj ka probleme të mëdha kur vijnë dërgesat brenda Kosovës. Ka raste kur refuzohen kur shihet diçka e tillë, ka raste kur dërgohen edhe në Serbi j. A lidhet kjo me ndonjë proces tjetër që e përmendët ju për kërkesën për një kod të ri postar, apo është diçka që do të mund të rregullohet në baza bilaterale?

Një raport që e kemi marrë ne, që është përgatitë nga ana e shoqërisë civile rreth përqindjes së zbatimit të MSA-së nga ana e institucioneve të Kosovës në 6 mujorin e parë, tregon se vetëm 27% e masave të parapara për 6 mujorin e parë janë zbatuar. Si qëndroni ju me përqindje të zbatimit në ministrinë tuaj konkrete, sepse ka disa ministri që qëndrojnë shumë më mirë dhe disa që janë te 10 apo 15%, prandaj totali po del diku 27%.

Time Kadrijaj: E dimë që ministria juaj është një njehsor mjaftë i rëndësishëm sa i takon implementimit të MSA-së. Unë sot e shfletova ueb faqen e ministrisë suaj dhe pash që faqja e strategjive është e zbrazët, nuk ishte publikuar asnjë strategji edhe pse parashihet me pas strategji.

Zhvillimi ekonomik ka ngec. Keni nxjerr shumë prioritetë si Qeveri por asnjë nuk po mund ta plotësoni. Si Komision e kemi nën mbikëqyrje zbatimin e MSA-së dhe shumë segmente të kësaj marrëveshjeje ndërlidhen edhe me ministrinë tuaj, andaj përveç Ligjit për Trepçën, i cili u miratua në Kuvendin e Kosovës, a jeni në diskutim të ndonjë strategjie zhvillimore?

Kur do të fillojnë punimet për ndërtimin e termocentralit të ri dhe sa kilovatë orë do të startojnë, sepse kemi pas shifra të ndryshme sa i përket çështjes së kilovatëve. A mund të na thoni në pika të shkurta çka përmban Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës 2016-2025, a do të mbetet edhe kjo strategji në letër sikurse projekti i termocentralit të ri?

Çka po ndërmerret nga ministria e juaj që të vijnë investitorët në Kosovë e jo të shkojnë në vendet e rajonit. Takimet në mes të dy Qeverive Shqipëri-Kosovë, nëse keni ndonjë shifër se sa është përmirësuar komunikimi ekonomik prej nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit, e kam fjalën për resorin që e udhëhiqni ju, sepse ne dëgjojmë që bizneset ankohen se ka ende barriera për shkëmbim ekonomik me Shqipërinë, por ka pengesa edhe me vendet tjera sepse sipas të gjitha gjasave fusnota e vendosur për Kosovën ju nxjerr shumë probleme bizneseve tona me rastin e eksportit. A keni kontakte me BE-në, sepse tash kohet e fundit është ndarë një buxhet për rajonin, por është edhe një goxha buxhet për Kosovën, ku do të investohen ato ?

Arben Gashi parashtrori dy pyetje për ministrin: ku qëndron problemi i interkoneksionit me Shqipërinë, pse nuk funksionon? A është e vërtetë deklarata e z. Rama, se është problem i trashëgimisë së pasurisë në mes Serbisë dhe Kosovës dhe pyetja tjetër mjetet e transportit kamionë dhe autobusë që kalojnë nëpërmjet Shqipërisë, detyrohen që mos të kenë më shumë se 200 litra naftë në rezervuarët e tyre, nëse kanë më shumë gjobiten të gjitha. A e keni shqyrtua këtë punë dhe a keni përdorë masa të reciprocitetit dhe a është ky një element që ndikon pozitivisht këtë në shkëmbimet tregtare në mes Shqipërisë dhe Kosovës?

Xhavit Haliti theksoi se ajo që më shqetëson më shumti është ambienti sa i përket prodhimit të energjisë me qymyr dhe besoj që është shqetësim i përgjithshëm i të gjithë banorëve përreth Obliliqit, mbi të gjitha tani po flitet për dhënie me koncesion ose sipas rregullave që i kemi në Kosovë, hulumtimeve të cilat pastaj derivojnë në leje për shfrytëzim, synim është Baseni i

Dukagjinit. Unë besoj që nuk ka milimetër katrorë të territorit të Kosovës, ku nuk dihet se ku ka qymyr dhe s'e kuptoj pse duhet me i dhanë dikujt leje në emër të hulumtimit të qymyrit...

Zona e Dukagjinit, e cila ka ajrin më të pastër në Kosovë është e destinuar do të thosha më shumë për turizëm dhe produkte bujqësore. Përse vonohet Ligji për energjinë e rinovueshme dhe drejta e privatëve të kenë mundësinë e instalimit. Pse të mos instalohen sistemet që janë edhe në Evropë, pse ne nuk jemi të koncentruar tek çështja e prodhimit të energjisë së rinovueshme, por veçmas nga gjitha vendet e Evropës të koncentrohemi te qymyri. Pse nuk liberalizohet tregu i energjisë në Kosovë. Për çka duhet ne me pas në monopol, qoftë shteti qoftë një kompani, sepse liberalizimi i qymyrit dhe i tregut ndikon pastaj tek mirëqenia e qytetarëve, ndikon tek konkurrenca e drejtë e atyre që shesin dhe atyre që blejnë energji, ia mundëson edhe qytetarit edhe bizneseve që të koncentrohen tek kompanitë të cilat kryejnë shërbime më të mira.

Mua sipas informacioneve të paargumentuara, më rezulton se çmimi i energjisë që do të prodhohet në Kosovë është më shtrenjtë se çmimi i energjisë që blihet në treg. Nëse është kështu, pse u dashka të prodhojmë energji elektrike, apo sepse u dashka me ja dhanë një kompanie e cila prodhon energji dhe na e shet neve më shtrenjtë. Kjo është ajo për te cilën desha të kem informacione.

Bislim Zogaj tha se sipas informacioneve, por edhe nga bisedat dhe takimet me njerëz, paraqitet problemi i shpronësimit të pronave në KEK, kur dihet që aty punojnë vetëm 5 ekskavatorë dhe nëse për një kohë shumë të shkurtër nuk bëhet shpronësimi i pronave, me siguri që do të bllokohet puna e tyre në nxjerrjen e qymyrit. Duhet urgjent të bëhet shpronësimi i pronave për të pas mundësi që KEK-u të mbajë licencën në hapësira tjera.

Duke u ndërlidh me pyetjen e deputetit Haliti, sa i përket liberalizimit apo mundësisë së konkurrencës në treg të rrymës, kemi rastin te Ferronikelit, i cili në kohët e fundit është detyruar të blejë rrymë nga jashtë sepse është më lirë se sa ne që e prodhojmë. Nëse ka mundësi për Ferronikelin me gjet rrymë më lirë, pse nuk ka mundësi edhe për qytetarët të ketë çmim më të ultë të rrymës?

Blerand Stavileci: Në kuadër të Presidencës, Traktatit të Komitetit të Energjisë, ne kemi parashtruar tri prioritete për vitin 2017, që janë në linjë të plotë me politikat rajonale të energjisë. E para është integrimi në tregun rajonal të energjisë elektrike dhe këtu kemi një kornizë matricore të masave, të cilat duhet secili vend ti përmbush, e dyta është ajo që besoj që do të jetë edhe në mënyrë të tërthortë përgjigjja edhe dy deputetëve, Zogaj dhe Haliti, që lidhet me liberalizimin e tregut, edhe këtu ne kemi manual të masave të buta me 4 komponentë që lidhen me liberalizimin e tregut dhe e treta është krijimi i bursave energjetike. Në region por e dhe në Evropë kemi disa shtete të cilat e kanë bërë bursën energjetike, edhe ne jemi duke përgatitë materialin që një të tillë ta bëjmë me Shqipërinë, si bashkëthemeluese e tyre dhe për këtë e kemi marrë modelin Skandinav.

Sa i takon punëtorëve të KEDS-it, ne kemi pasur disa takime me organizatat që i përfaqësojnë punëtorët, aty kanë qenë dy çështje, çështja e kontratave dhe po ashtu çështja e kontratës kolektive që është dashur ta bëjnë me BSPK-në dhe me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ne në vazhdimësi i kemi bartur shqetësimet e tyre në mënyrë që të shohim se cila do të jetë mënyra e zgjidhjes së këtij problemi dhe i kemi prezantuar disa prej tyre dhe iu kemi komunikuar atyre dhe kontratat e tyre kanë qenë nga muaji maji vitit 2013 deri në muajin maj të vitit 2016.

Unë mendoj që në kuadër të kësaj strategjie për vitet e ardhshme do të kemi mundësinë për të bërë zgjidhje të kombinuara dhe të pjesshme, nëse keni pas takime me këta punëtorë ju kanë treguar që edhe aty nuk ka pasur menjëherë masë drastike pa u bërë një zgjidhje, sepse ju kanë

paralajmëruar edhe ata për një lloj kundër shpërblimi për vitin e parë, që nuk do të thotë që ata nuk do të mund të riintegrohen.

Investimet të cilat duhet ti bëjë KEDS-i , po i bën në harmoni me planin e investimeve të tyre dhe unë kam marrë pjesë në dy prej këtyre takimeve ku është prezantuar plani i investimeve i zgjerimit të rrjetit dhe mirëmbajtjes, është e vërtetë që ka mirëmbajtje por ka edhe shumë investime të reja të cilat i keni parë që ata i prezantojnë.

Ju e dini që e kemi Zyrën e Rregullatorit të Energjisë ZRE, që është një trup që është jashtë kompetencës qeveritare, por që ne jemi munduar që edhe për agjendën evropiane edhe për problemet që janë paraqitur edhe për KEDS-in edhe për punëtorët e KEK-ut gjithmonë ti bashkërendojmë aktivitetet edhe me ta dhe në momentin që ka një kërkesë nga ato dhe ajo nuk aprovohet nga ZRRE-ja atëherë është e pamundur që të impelmentohet. Po ashtu, shumë prej përgjigjeve në pyetjet që ju i parashtruat do të gjejnë zgjidhje me këtë pakon e tretë të ligjeve.

E mira është se si te ky proces ashtu edhe te proceset tjera tash së fundi edhe Trepça edhe Kosova e re do të jenë vendime që nuk do të merren vetëm nga njëra palë po besojë që ato do të trajtohen dhe shtjellohen në Kuvend dhe pastaj me votën e juaj do të ecet tutje apo do të ndalen ato projekte...

Sa i takon tash çmimeve, liberalizimit dhe elementeve tjera, ne nuk pajtohemi që ta kemi skenarin e importit, po skenarin e sigurisë së furnizimit, sepse kemi politikat e bashkëpunimit rajonal dhe në këtë rast askush më mirë se ne dhe Shqipëria nuk mund të kompletohem...

Sa i takon pjesës së dekomisionimit të Kosovës A , do ta shihni tek strategjia që do të vijë tek ju dhe do ta shihni që ne me të gjithë skenarët e kemi lidhur fatin e dekomisionimit në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese derisa të hyjë në funksion Kosova e Re, me orë të limituara apo pa orë të limituara, është një direktivë e BE-së e cila nuk lejon pra të ketë orë të pakufizuara të operimit po duhet të ketë orë të kufizuara.

Lidhur me çështjen e shërbimeve postare, Stavileci tha se sot kemi më tepër aktivitete të vetë postës sonë sepse edhe këtu kemi Autoritetin rregullativ të komunikimeve elektronike dhe postare AKEP, shumë prej këtyre çështjeve i rregullon. Ne kemi edhe një matricë të përbashkët në agjendën se si veprojmë ,por duhet ditur që edhe në kuadër të marrëveshjeve të Brukselit, ka një pikë e cila do të fillojë të zgjidhet pasi të implementohet marrëveshja për telekomunikacionin e ajo lidhet së pari me zhblokimin e një procesi të bllokuar me obstrukcionet që i bën pala tjetër, që nuk është bashkëpunuese .

Për Trepçën tha se gjithë e dimë se cilët janë hapat konsekuentë logjikë të një procesi se si bëhet një strategji, niset parafizibiliteti, fizibiliteti, strategjia dhe ligji, është një hap shumë i mirë që ne e kemi fizibilitetin, i cili do te përfundojë deri në fund të muajit shkurt nga Agjencia e Privatizimit dhe prej muajit shkurt edhe me Ligj, do ta kemi strategjinë për Trepçën.

Për Kosovën e re, aty e kemi investitorin e huaj, është kompania Amerikane shumë serioze dhe ne kemi 1 miliard euro investime. Me këto investime krijohen 10 mijë vende të punës gjatë periudhës së ndërtimit, 550 pasi të hyjë në operim, edhe për ambientin do të jetë një efikasitet 40%, ka qenë 37% . Unë e kam gjet projektin kur qeveria është dashtë të kontribuojë me 200 milionë euro, një efikasitet 37% me rritje të çmimit të energjisë elektrike për 90%.. Sot nuk e kemi asnjë kontribut prej buxhetit të shtetit dhe kjo ndikon në rritje të GDP-së për 2%.

Lidhur me shpronësimet, nuk duhet të ketë politika të shpronësimit, është diçka që nëse ne bëjmë një hap për t'i shpronësuar në mënyrë të dhunshme ose në ndonjë mënyrë tjetër, Bankën Botërore menjëherë e kemi jashtë projektit dhe jashtë çdo investimi në të ardhmen. Kemi bërë

gjithçka që të zbatohet korniza e politikave të zhvendosjes e cila është aprovuar në Qeveri në vitin 2011.

Donika Kadaj-Bujupi: Kërkoj nga ministri që me shkrim në Komision ti përcjell përgjigjet për këto dy pyetje.

1.KEDS-i është privatizuar me kontratat konform ligjeve të punës të cilat janë funksionale në Kosovë. Çka do të ndodh me këta 300 punëtorë duke marrë parasysh që janë largu jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe janë largu edhe pse kanë pas kontrata të përhershme, kurse ata të cilët kanë pas kontrata të përkohshme , në vitin 2012, Qeveria ishte zotu që KEDS-i do ti vazhdojë kontratat e përkohshme tri vjeçare, siç ka qenë në të kaluarën.

2. Ju folët shumë edhe për energjinë alternative, a është e vërtet që katër hidrocentralet i janë dhënë KEDS-it në shfrytëzim për 10 vitet e ardhshme, sepse kjo ka mbetur si e megjulluar ?

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05\101 për performancën energjetike në ndërtesa me amendamentet e Komisionit Funksional me aspektin e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin lidhur me Projektligjin dhe tha se pas shqyrtimit dhe verifikimit lidhur me përafrimin me legjislacionin e BE-së të Projektligjit, së bashku me amendamentet e propozuara të Komisionit Funksional, është konstatuar se nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit e BE-së , prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pasi nuk kishte vërejtje, kryetarja e Komisionit konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë :

Rekomandim

Projektligjit nr.05\101 për Performancën energjetike në ndërtesa me amendamentet e Komisionit Funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet në Kuvend për miratim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit numër 05\L\100 për ndihmën shtetërore me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj, pas shqyrtimit dhe verifikimit lidhur me përafrimin e Projektligjit nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, vlerësojmë se ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Pasi nuk kishte vërejtje, kryetarja e Komisionit konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji numër 05\L\100 për ndihmën shtetërore me amendamentet e Komisionit Funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet në Kuvend për miratim.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinionin ligjor, pas shqyrtimit dhe verifikimit lidhur me përafrimin e Projektligjit së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional. Ajo vlerësoi se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Vjosa Osmani tha se është kundër sepse njëra prej arsyeve është se me këtë ndryshim të Projektligjit do të atakohen kryesisht gratë dhe kjo i qet në pozitë të pabarabartë në raport me gjininë tjetër .

Donika Kadaj tha se me këtë Projektligj iu cenohet e drejta 80 mijë femrave dhe vërejtjet do ti paraqes në seancë plenare.

Kryetarja pas votimit të Komisionit, konstatoi se Komisioni me 3 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime nxori këtë ;

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L- 116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk përkrahen nga Komisioni për Integritet Evropian.

Të ndryshme .

Në këtë pikë kryetarja propozoi që Komisioni në mbështetje të Grupit për Studime Juridike dhe Politike edhe me ministrin për Integritet Evropian ta organizojmë bashkërisht një tryezë me shoqërinë civile, për të vazhduar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre edhe në fushat tjera ku mendon se është e domosdoshme.

Vjosa Osmani tha se pikërisht për Projektligjin për Fondet Pensionale, na ishte dashtë përkrahja e ministrit për të dalë në një arsyetim të mirë pse po e kundërshtojmë ose ta angazhojmë edhe dikë nga jashtë, për një ekspertizë të shpejt. Do të ishte mirë që për shqyrtimin dhe analizimin e ligjeve të ketë së paku një muaj kohë, sepse kjo kohë e përcaktuar për shqyrtim është shumë e shkurtër.

Fatmir Xhelili dhe Bislim Zogaj thanë se ndoshta do të ishte mirë që nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale të vijnë në Komision dhe të japin sqarime shtesë .

Në fund kryetarja konstatoi se Komisioni përkrahu propozimin për organizimin e konferencës me shoqërinë civile.

Mbledhja përfundoi në orën 14:35.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini